

Kot: 1877/3
Dt: 30.03.2021.

**AKT I THEMELIMIT I SHOQËRISË "SENA SOLAR ENERGY OF ALBANIA" SH.A.
SHOQËRI AKSIONARE ME OFERTË PRIVATE**

Sot, më datë 30/03/2021, në Tiranë, në cilësinë e Aksionarit të Vetëm, shoqëria "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a. (akronim KESH sh.a.) shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, regjistruar si person juridik i së drejtës shqiptare me Vendimin Nr.12728 Akt. i datës 3.11.1995 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në Bllokun Vasil Shanto, Rr. Viktor Eftimiu, Tiranë, pajisur me NUIS J61817005F me përfaqësues ligjor, Administratorin z. Besjan KADIU lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr.035438171, madhor me zotësi të plotë për të vepruar;

bazuar në nenin 24, 26 e vijues të Kodit Civil të RSH, nenin 1, 3, 68, 207 e vijues të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nenin 22/c të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", neni 3 e vijues i Ligjit Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", në përputhje por pa u kufizuar në legjislacionin sektorial të energjisë, pasi ka miratuar Statutin si akti rregullues i shoqërisë nëpërmjet këtij akti bie dakord të themelojë shoqërinë aksionare "SENA Solar Energy of Albania" sh.a., me parashikimet si më poshtë.

NENI 1
THEMELIMI

Shoqëria aksionare me ofertë private "SENA SOLAR ENERGY OF ALBANIA" (në vijim referuar si **Shoqëria**) themelohet për të zhvilluar veprimtari tregtare sipas Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në Tiranë. Shoqëria është person juridik shqiptar, veprimtaria e së cilës rregullohet nga akti themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

NENI 2
SELIA

2.1 Selia e shoqërisë është në adresën Blloku Vasil Shanto, Rruga "Viktor Eftimiu", Nd.26, H.1, Tiranë, si dhe do të ushtrojë veprimtari tregtare në Vau Dejë.

2.2 Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë degë, zyra dhe/ose të ushtrojë aktivitet tregtar në vende të tjera, qoftë brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktet rregullatore dhe ato ligjore.

NENI 3
KAPITALI THEMELTAR

3.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 3.500.000 (tre milion e pesëqindmijë) lekë. Kapitali themeltar ndahet në 10 (dhjetë) aksione të zakonshme secila me vlerë nominale 350,000 (treqind e pesëdhejtë mijë) lekë.

3.2 Kapitali është nënshkruar dhe derdhur tërësisht nga Ortaku i Vetëm, shoqëria "Korporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a., zotëruese e 100% të kapitalit konfirmuar me mandatin lëshuar nga Banka e nivelit të dytë.

3.3 Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapital.



NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

4.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë është përfshirja në çdo transaksion të ligjshëm dhe/ose angazhimi në aktivitete të ligjshme për qëllime të të cilave mund të themelohet një shoqëri aksionare sipas ligjeve të Shqipërisë, me ndryshimet e tyre të herë pas hershme, ku përfshihet pa kufizim sa më poshtë:

- a. studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impiantit fotovoltaiik lundruar në liqenin e HEC Vau Dejë dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike;
- b. prodhimi, shitja, tregtimi, studimi, përgjithësisht të gjitha shërbimet mbështetëse në fushën e industrisë dhe energjisë;
- c. pjesëmarrja në tendera të të gjitha llojeve në fushën e energjisë qoftë shqiptar apo i huaj;
- d. aktivitete tregtare në fushën e energjisë;
- e. kryerja e çdo aktiviteti tregtar e çdo veprimi në Shqipëri apo jashtë saj, që ka lidhje të drejtpërdrejt apo të tërthortë me objektin e mësipërm të Shoqërisë ose që është e nevojshme për promovimin e biznesit të Shoqërisë dhe për arritjen e objektivave të Shoqërisë.

5.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi. Mund të kryejë çdo lloj aktiviteti në raport me objektin për të cilin është krijuar. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet e duhura nënligjore dhe ato rregullatore.

NENI 5

KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet sipas rasteve dhe mënyrave të parashikuara në ligj dhe statut.

NENI 6

AKSIONERI I VETËM, NËNSHHKRIMI

Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., shoqëri e themeluar dhe që vepron sipas rregullimit ligjor në Shqipëri, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J61817005F, me adresë Blloku Vasil Shanto, Rruga "Viktor Eftimiu", Nd.26, H.1, Tiranë.

Emri i aksionarit	Nr. i aksioneve	Vlera Nominale në Leke	Vlera e Kapitalit në Lekë	Pjesmarrja në %
KESH sh.a. NUIS J51817005F	10	350,000	3,500,000	100

Pronësia e aksioneve pasqyrohet në Regjistrin e Aksioneve të mbajtur nga shoqëria.

NENI 7

ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga (I) Asambleja e Ortakëve dhe (II) Këshilli i Administrimit (iii) Administratori/ët.

Aksioneri i vetëm i shoqërisë "**SENA SOLAR ENERGY OF ALBANIA, SH.A.**" i ushtron të drejtat dhe detyrimet ndaj shoqërisë nëpërmjet Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve si organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë.

Këshilli i Administrimit dhe Administratori i shoqërisë drejtojnë veprimtarinë operative të shoqërisë sipas tagrave dhe kufizimeve të parashikuara në ligj dhe Statut.

Administratori emërohet nga Këshilli i Administrimit sipas parashikimeve të Statutit



Administrator i shoqërisë është emëruar znj. Erideta BASHI.

Anëtarët e parë të Këshillit të Administrimit, të zgjedhur nga Mbledhja e Asamblesë së Shoqërisë, janë:

- | | |
|-------------------|---------|
| 1. Jonid KAZANI | Kryetar |
| 2. Mariglen SHULI | Anëtar |
| 3. Dritan DEMA | Anëtar |

NENI 8 **EKSPERTËT KONTABËL**

Ekspertët kontabël emërohen me vendim të Asamblesë së Aksionerëve në çdo rast kur është e nevojshme sipas legjislacionit shqiptar ose kur Asambleja e Ortakëve e gjykon të nevojshme.

Ekspertët e parë kontabël të autorizuar, emëruar nga Aksionari Themelues janë:

1. Znj.Fatime Alliu, me Nr.Licensë 166, datë 21.09.2007 mbajtëse e NIPT K72215028T dhe seli Rr. Luigj Gurakuqi, P. 8, Shk. 1, Ap. 21, Tiranë, letërnjoftim me numër personal G25210338Q, dhe
2. Z.Ermir Veipi, me Nr.Licensë 261, datë 27.08.2021 mbajtës i NIPT K81506022D dhe seli Blv. Gjergj Fishta, kulla Gora Nr.2, kati 10, letërnjoftim me numër personal H60507054P.

NENI 9 **VITI FINANCIAR**

- 9.1 Viti financiar i shoqërisë fillon më datë 1 Janar dhe përfundon më datë 31 Dhjetor
- 9.2 Përfundimisht, viti i parë financiar fillon pas themelimit dhe regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më datë 31 Dhjetor të po të njëjti vit.

**Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në Statutin e saj.*

Autorizohet Z. Erion Marku, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal I60809055U për të kryer regjistrimin e kësaj shoqërie pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Ky Akt Themelimi i shoqërisë "**SENA SOLAR ENERGY OF ALBANIA sh.a.**" hartohet në 3 kopje dhe nënshkruhet rregullisht nga Aksionari i Vetëm, sot më datë 30 / 03 / 2021, në Tiranë

AKSIONARI THEMELUES **KOORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SH.A.**

ADMINISTRATORI
z. Besjan KADIU

